



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 84, datë 29.12.2016

**PËR**

**“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2017-2019 DHE  
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2017”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1/ 1.1 shkronja “b”, pika 1/ 1.3 shkronjat “a” dhe “c” nenit 41, nenit 54, shkronja “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”; nenit 140, nenit 149 të ligjit nr.7961 datë 12.07.1995“ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”; neneve 6, 15, 17 dhe 32 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 2 dhe nenit 10 të Ligjit Nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr. 8, datë 29.03.2012 për “Procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017-2019 si më poshtë vijon.

1.1 Plani i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017-2019, është në shumat si më poshtë:

*Në lekë*

<b>Plani i të ardhurave</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
<b>Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore</b>	<b>11,863,800,000</b>	<b>11,905,000,000</b>	<b>12,136,060,000</b>
- Të ardhura tatimore	7,074,590,000	7,249,500,000	7,437,060,000
- Të ardhura jo tatimore	4,789,210,000	4,655,500,000	4,699,000,000
<b>Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar</b>	<b>1,913,119,744</b>	<b>1,951,382,139</b>	<b>1,990,409,781</b>
<b>Te ardhura te mbartura nga viti 2016</b>	<b>650,000,000</b>		
<b>Totali</b>	<b>14,426,919,744</b>	<b>13,856,382,139</b>	<b>14,126,469,781</b>

1.2 Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2017-2019, është në shumat si më poshtë:

*Në lekë*

<b>Plani i shpenzimeve</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
<b>Shpenzime korrente</b>	8,432,102,883	8,615,710,883	8,636,710,883
<b>Shpenzime kapitale</b>	5,994,816,861	5,240,671,256	5,489,758,899
<b>Totali</b>	<b>14,426,919,744</b>	<b>13,856,382,139</b>	<b>14,126,469,781</b>

1.3 Transferta specifike për financimin e funksioneve të reja është si më poshtë:

*Në lekë*

	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
<b>Transferta specifike për financimin e funksioneve të reja</b>	874,641,053	892,133,874	909,976,552
<b>Totali</b>	<b>874,641,053</b>	<b>892,133,874</b>	<b>909,976,552</b>

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017 si më poshtë:

- 2.1 Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrës Nr.1, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- 2.2 Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrës Nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.3 Të miratojë detajimin e shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrave Nr.3 dhe Nr.3/1 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- 2.4 Të miratojë detajimin dhe shpërndarjen e transfertës specifike për financimin e funksioneve të reja sipas Pasqyrës Nr.3/2 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- 2.5 Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale sipas programeve sipas Pasqyrës Nr.4 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
- 2.6 Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2017.

3. Të miratojë një numër prej 75 punëtorë me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për vitin 2017 për Drejtorinë e Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit për një periudhë 3 mujore (Shkurt –Prill) si dhe një numër prej 50 punëtorë me kontratë me kohëzgjatje të caktuar për vitin 2017 për Drejtorinë e Përgjithshme Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit për një periudhë 3 mujore (Prill- Qershor), me pagë bruto 30,000 lekë/muaj.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e

Përgjithshme e Komunikimit dhe marrëdhënieve me Publikun, Institucionet në varësi të Bashkisë së Tiranës.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**